

VENDIM
Nr.572, datë 28.5.2009

**PËR MIRATIMIN E LISTËS PARAPRAKE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME
PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM
TË KOMUNËS QENDËR VLORË TË QARKUT TË VLORËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 2, 3 e 17 të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e listës paraprake të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të komunës Qendër Vlorë, të qarkut të Vlorës, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Lista paraprake, sipas kërkesave të këshillit të kësaj komune, është pjesë e listës së inventarit të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që janë brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të komunës Qendër Vlorë të qarkut të Vlorës, miratuar me vendimin nr.1528, datë 19.11.2008 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore në komunën Qendër Vlorë të qarkut të Vlorës”.

2. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe komuna Qendër Vlorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

Komuna Qendër Vlorë

Lidhja nr.1

Numrat rendorë të pronave në listën e inventarit	Fusha e përdorimit të pronës	Lloji i transferimit
68-87	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore. (disa prona ndodhen në një ndërtesë)	Në pronësi
88-94,96-100	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
102-104,107-115	Prona që përdoren për realizimin e veprimtarive social-kulturore e sportive.	Në pronësi
116-126	Varreza publike	Në pronësi
131-180	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e zhvillimit ekonomik.	Në pronësi
181-581,585,587-591.593-603,775,778,781-791,820,831,836,897,898,902,909,910,915, 916	Infrastrukturë (sheshe, rrugë vendore, lulishte dhe shërbime publike)	Në pronësi

604-774,776-780,792-819,832-835,837-896,899-901,903-908,911-914,917-934	Troje të lira dhe hapësira publike të pazëna ndërmjet ndërtesave ose objekteve të çdo lloji.	Në përdorim
935,936,937,939-948,950,951,952,953,955-958,960,961,962,964-967,969,970,972-974,976-978	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive).	Në përdorim
938,949,954,959,963,968,971,975,979,1005,1025,1026,1027,1028,1069,1070,1071,1072,1076-1084,1099-1118	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (kanale të treta dhe toka joproduktive).	Në pronësi
1224-1251	Prona që përdoren për ushtrimin e funksioneve në fushën e ujësjellës-kanalizimeve.	Në pronësi